



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “K.Turja” shpk**  
**Adresa: Budull, prane Ures se Gjoles. , Budull, Kruje,**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” “Sistemim Asfaltim i rrugës “Haxhi Brari”**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81994-08-03-2018.**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Sistemim Asfaltim i rrugës “Haxhi Brari”**

**Fondi limit: 11,666,659.40 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë dyzetë) lekë pa TVSH**

**Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr.63, datë 07.06.2018 për disa ndryshime në Vendimin Nr. 132, datë 21.12.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018” (i ndryshuar)”**

**Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.**

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 16.08.2018, ora 11:00**

**Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 13.08.2018**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme**

**Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

- 1. Operatori ekonomik “Shkëlqimi-07” shpk NUIS K68121808W**

**Vlera e ofertës = 7,000,000.00 (shtatë milion ) lekë pa TVSH.**

- 2. Operatori ekonomik “K-AAV” shpk NUIS L51506025C**

**Vlera e ofertës: 8,764,874.95 (tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH**

**3. Operatori “Ndertimi shpk” NUIS K11325002C**

Vlera e ofertes : **9,336,033.00** (nëntë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH

**4. Operatori ekonomik “K.Turja” shpk NUIS K81314014A**

Vlera e ofertes: **10,374,735.00** (dhjete milion e treqind e shtatedhjetë e kater mije e shtateqind e tridhjetë e pese) lekë pa TVSH

**5. Operatori ekonomik “Shendelli” shpk NUIS J69102508C**

**Vlera e ofertës: 11,552,558** (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

**6. Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk NUIS K71401004W**

Vlera e ofertës: **11,672,475.16** njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:  
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqimi-07” shpk**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 7,000,000.00 (shtatë milion ) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = 8,400,000.00 (tetë milion e katërqind mijë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3(tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori ekonomik “Shkëlqimi-07” shpk nuk ka paraqitur formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore cka bie në kundërshtim me pikën 4, gërma “g” të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Janar 2018 - Qershor 2018 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”. KVO konstaton se është paraqitur një deklaratë nga vetë operatori ekonomik se pagesat janë kryen online nëpërmjet sistemit banker por nuk figuron asnjë document që ta faktojë këtë.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, me targë AA 6170A, të deklaruar nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk konstatoi se mjeti rezulton te jete i montuar kamion i certifikuar per transport mallrash brenda vendit + cisterne bitumi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin Autobitumatriçe, me targë AA6170A të deklaruar nga operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk konstaton se nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “b”.
- Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 10, mjetin “Fadromë me Goma” cka bie në kundërshtim me pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”.

## **2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “K-AAV” shpk**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 8,764,874.95 (tetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = 10,517,849.94 (dhjetë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e nëntë e nëntëdhjetë e katër) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3(tre)muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori ekonomik “K-AVV” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore ( 2016, 2017) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: 5,833,329.70 (pesë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e nëntë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH” pasi mesatarja e xhiros vjetore për 3 vitet e kërkuar rezulton më e vogël, në vlerën 4,442,030 (katër milion e katërqind e dyzetë e dy mijë e tridhjetë) lekë.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekoikoik nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit teknik: ” Një punësim mesatar i të paktën 25 (njëzet e pesë) personave,

për periudhën Janar 2018 - Qershor 2018 të vërtetuar...” pasi nga verifikimi I vertetimit për kontributet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e kërkuar rezultoi I punësuar vetëm 1 punonjës.

- Gjithashtu në listpagesat e kërkuara për periudhën Janar 2018-Qershor 2018 rezultoi vetëm 1 punonjës cka dëshmon që operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat për stafin teknik dhe për punonjësit të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) të cilët duhet të figurojnë të list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3(tre) muajt e fundit.
- KVO konstaton se operatori ekonomik nuk posedon në licensë pikën: “N.P –11A (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike)” cka bie në kundërshtim me pikën 2 të kapaciteti teknik të DST.
- KVO konstaton se operatori ekonomik nuk posedon në licensë pikën: “N.P -12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)” cka bie në kundërshtim me pikën 2 të kapaciteti teknik të DST.

### **3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Ndertimi shpk”**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 9,336,033.00 (nëntë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tre) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = 11,203,240.00 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e tre mijë e dyqind e dyzetë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3(tre)muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori ekonomik “Ndertimi” shpk nuk ka paraqitur vertetimin e shlyerjes së detyrimeve të energjisë elektrike, cka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1.
- Operatori ekonomik “Ndertimi” shpk nuk ka paraqitur për Inxhinierin e Mjedisit certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisëshuar nga Ministria e Mjedisit, cka bie në kundërshtim me DST tek Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 5.

•

### **4. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 11,552,558 .00 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = 13,863,070.00 (trembëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3(tre)muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë

20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk ka paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika
- Operatori ekonomik “Shendelli” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë mjekun e përgjithshëm (D.Y). Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur librezën e punës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik “Shendelli” shpk ka deklaruar se disponon 7 (shtatë) kamionçina përkatësisht me targa AA 347 KE; AA 959 GS; AA 074 PU; AA 264 OB; AA 693 OY; AA 288 CF si dhe AA 512 OB. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se kamionçina me targë AA 347 KE ka kapacitet mbajtës 1.9 Ton; mjeti me targë AA 959 GS ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton; mjeti me targë AA 264 OB ka kapacitet mbajtës 0.9 Ton; mjeti me targë AA 693 OY ka kapacitet mbajtës 1 Ton; mjeti me targë AA 512 OB ka kapacitet mbajtës 3.9 Ton. Për kamionçinat e deklaruara me targa AA 074 PU dhe AA 288 CF, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”.
- Operatori ekonomik për Autobetonieret e disponuara sipas Kontratës së Qirasë me Nr. 1804 Rep. Nr. 604 Kol. datë 25.07.2018 nuk ka paraqitur Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “a”. Ndërsa për Autobetonieret e deklaruara sipas Shtojcës 10 me targa AA 464 PU dhe AA 471 PU nuk ka paraqitur dokumentacion. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobetoniere”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk ka deklaruar se disponon Autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe”.

##### **5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk**

Çmimi total i ofertës pa TVSH 11,672,475.16 lekë pa TVSH (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë)

lekë. Çmimi total i ofertës me TVSH = 14,006,970.19 (katërbëdhjetë milion e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë pikë nëntëmbëdhjetë) lekë. Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 3(tre)muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi listpagesat e shoqërisë “Kevin Konstruktion” shpk për periudhën Janar 2018 – Qershor 2018, konstatoi se nuk janë të shoqëruara me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3 gërma “b”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur për stafin teknik, konstatoi se Inxhinieri i mjedisit (U.K) i deklaruar nga Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk nuk është të pajisur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk nuk ka paraqitur asnjë kontratë pune për punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- KVO konstatoi se Dëshmia e kualifikimit e paraqitur për teknikun e ndërtimit (Z.N) nuk është e vlefshme, pasi i ka përfunduar afati i vlefshmërisë më datë 16.03.2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “Kevin Konstruktion” shpk nuk ka paraqitur asnjë kontratë pune për punonjësit manovrator, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.
- Gjithashtu Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk nuk ka paraqitur Grafikun e Punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit për 3 (tre) muaj kalendarike, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9 ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 3 (tre) muaj kalendarike.”
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një)



Autobitumatriçe”.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Asfaltoshtruese, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Asfaltoshtruese”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobetoniere”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Autovinç, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autovinç”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Makineri vijëzimi me bojë bikomponente, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Makineri vijëzimi me bojë bikomponente”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Rrul me kompresor, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Rrul me kompresor”.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Shtojcën 10, konstatoi se Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk ka deklaruar se disponon Rrul me vibrim, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15 ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Rrul me vibrim”.
- Kamionçinat e deklaruar në Shtojcën 10 nga Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk nuk kanë kapacitetin mbajtës sipas përcaktimeve të DST. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”.

- Gjithashtu Kamionat e deklaruar nga shoqëria “Kevin Konstruksion” shpk sipas Shtojcës 10, nuk kanë kapacitetin mbajtës sipas përcaktimeve të DST. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamiona me kapacitet mbajtës minimum 10 ton”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “K.Turja” shpk**, me adresë: **Budull, pranë Ures se Gjoles, Budull, Kruje**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **10,374,735.00** (dhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 20.08.2018**

